Funded by the European Union

Projekti i infrastrukturës dhe i nxitjes së turizmit në Shqipëri



Duration: 01.12.2020 - 31.12.2027

Countries:
Albania

EU contribution: € 40 000 000

Total budget: € 105 000 000

Implementer:
European Bank for Reconstruction and Development (EBRD)

Website(s): euprojects.al/euprojects/tourism-led-model-for-local-economic-development-support-programme-2/

Project description:

Projekti i infrastrukturës dhe i nxitjes së turizmit në Shqipëri (AITP) është një program i përbashkët BE-BERZH(Bashkimi Evropian – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), që mbështet zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Shqipërisë të udhëhequr nga turizmi. Ai ndërthur financimin e BERZH-it dhe grantet e BE-së për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e sektorit turistik të Shqipërisë, duke:
•zhvilluar produkte dhe destinacione turistike;
•restauruar dhe përmirësuar asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
•përmirësuar infrastrukturën bashkiake dhe transportuese;
•rritur aftësitë dhe;
•zgjeruar aksesin në financim për NVM-të (Ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme).
Programi fokusohet në bashkitë pilote të Beratit, Fierit, Korçës dhe Shkodrës. Ai zbatohet përmes katër dritareve të ndërhyrjes:
•Dritarja 1 – Asistencë teknike me fokus te turizmi, që përfshin zhvillimin e destinacioneve, krijimin e produkteve turistike, shërbimeve këshillimore për NVM-të, zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen gjinore dhe ekonomike.
•Dritarja 2 – Rehabilitimi i siteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, që përfshin financimin e restaurimit, ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
•Dritarja 3 – Rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës bashkiake dhe transportuese, që përfshin përmirësimin e infrastrukturës bashkiake dhe të transportit, i cili mbështet turizmin, për të rritur aksesueshmërinë, lidhshmërinë dhe qëndrueshmërinë ndaj klimës.
•Dritarja 4 – Linja kredie ose ndarje e rrezikut përmes institucioneve financiare pjesëmarrëse (PFI), që përfshin zgjerimin e mundësive të financimit për NVM-të e lidhura me turizmin.
Duke ndërthurur investimet, asistencën teknike, shërbimet këshillimore dhe stimujt, AITP promovon zhvillimin e destinacioneve, rritjen e aftësive, përfshirjen gjinore dhe ekonomike, infrastrukturën e qëndrueshme ndaj klimës dhe rritjen e sektorit privat.

Expected results:
•rritja e kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit dhe e numrit të vizitorëve në destinacionet pilote të Beratit, Fierit, Korçës dhe Shkodrës;
•trainimi dhe zhvillimi i aftësive të paktën 2,000 pjesëmarrësve të sektorit të turizmit dhe i më shumë se 200 ekspertëve nga institucionet publike dhe sitet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me gratë që përbëjnë të paktën gjysmën e të gjithë përfituesve;
•restaurimi dhe përmirësimi i 24 aseteve të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe i infrastrukturës së lidhur me turizmin;
•mobilizimi i financimit të BERZH-it përmes institucioneve financiare pjesëmarrëse, për të zgjeruar aksesin në financim dhe për të forcuar konkurrueshmërinë e NVM-ve të lidhura me turizmin.